

01-1000 Dt. 07-05-2018  
PRISHTINË - PRISHTINA



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.  
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: [info@iber-lepenc.org](mailto:info@iber-lepenc.org)

Për: z. Valdrin Lluka, Ministër i Zhvillimit Ekonomik

- z. Nazmi Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
- Mjetet e informimit publik: zeri.info, gazetaexpress.info etj.

Cc: z. Ramush Haradinaj, Kryeministër i Republikës së Kosovës

- Komisioni Ndër-ministoror për Ndërrmarje Publike

Nga: Bordi i Drejtorëve të N.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A., Prishtinë

Lënda: Reagim

Të nderuar,



Nga mjetet e informimit si zeri.info, gazetaexpress.com etj., me dt. 04.05.2018, jemi njoftuar me përmbajtjen e Propozim-Vendimit për shkarkim të shumicës së drejtorëve në Bordin e Drejtorëve të N.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A. Prishtinë.

Të pakënaqur me përmbajtjen e Propozim-Vendimit paraqesim këtë

## REAGIM

Për arsytet si në vijim:

1. I nderuar Ministër në respektim të Ligjit 03/L-087, nenit 7, respektivisht paragrafit 7.5, komunikimi në mes Aksionarit dhe Ndërrmarjes Publike bëhet duke e respektuar institucionin dhe ligjet që e rregullojnë këtë çështje dhe në asnjë mënyrë përmes medieve, formë të cilën e keni zgjedhur ju në këtë rast.

1.   
2.   
3. A.M.  
4. S.V.

N.H. "Ibër-Lepenc" është një ndër Ndërrmarjet më të suksesshme në Republikën e Kosovës falë punës profesionale, vizionit dhe anagazhimit permanent të Bordit të Drejtorëve. Për afarizmin e suksesshëm të kësaj Ndërrmarje jeni njoftuar edhe ju z. Ministër Lluka me rastin e vizitës që ja keni bërë N.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A. me dt 22.12.2017, me ç'rast keni lëshuar komunikatë në ueb-faqen e Ministrisë, duke vlerësuar lartë performancën e kësaj Ndërrmarje (më gjerësisht të lexohet komunikata për shtyp në ueb-faqen e MZHE-së pas vizitës së Ministrit Lluka me stafin e tij në Ndërrmarjen "Ibër-Lepenc" dt 22.12.2017).

Me iniciativën e juaj z. Ministër Lluka, me dt. 06.04. 2018, jemi takuar në MZHE ne, Kryesuesi i Komisionit të Auditimit dhe Kryeshefi Ekzekutiv i "Ibër-Lepencit" me Kryesuesin e Bordit dhe Kryeshefin Ekzekutiv të "KRU Mitrovica", ne lidhje me detyrimet të cilat i ka "KRU Mitrovica" ndaj N.H. "Ibër-Lepenc", takim ky në të cilin ju personalisht, bazuar në **qëndrueshmërinë financiare të Ndërrmarjes "Ibër-Lepenc"** keni rekomanduar fleksibilitet nga N.H. "Ibër-Lepenc" për borxhet të cilat i ka "KRU Mitrovica". Ne, në cilësinë e Bordit të Drejtorëve, duke respektuar pozitën e juaj, kemi aprovuar rekomandimet e juaja, në raport me "KRU Mitrovica", **duke vlerësuar, sikurse edhe ju, qëndrueshmërinë financiare të Ndërrmarjes N.H. "Ibër-Lepenc"**.

2. Vendimi për dhënie të bonusit është i bazuar në Ligjin për Ndërrmarjet Publike përkatësisht nenet 20, 21 dhe 22 të Ligjit 03/L-087, nenin 12 të Ligjit 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e e Ligjit nr. 03/L-087 për NP, Deklaratën për Politikat e Kompenzimit për Bordin e Ndërrmarjes dhe zyrtarëve të Ndërrmarjes për vitin 2017 nr.01-383 dt. 28.02.2017, dispozitat e nenit 29 paragrafit 6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Koroporative për NP, Planin e Biznesit 2017, Raportin e Auditorit të Pavarur për Auditimin e Pasqyrave Fianciare për vitin 2017, Rekomandimin e menaxhmentit përmes KE me shkresën 01-707 dt 03.04.2018, Rekomandimin e Auditorit të Brendshëm shkresa dt 04.04.2018 për Bordin e Drejtorëve-Komitetin e Auditimit, Rekomandimet e Komitetit të Auditimit të dalura nga mbledhja e mbajtur me dt 06.04.2018, dhe me Rekomandimet e Komitetit për Staf dhe Shpërblime, nr 01-768 dt 10.04.2018.

1. S.  
2. J.  
3. A.M.  
E.S.V.

Vendimi për dhënje të bonusit është marë më dt. 10.04.2018, në pajtim me bazën ligjore për këtë çështje dhe pas zhvillimit të të gjitha procedurave paraprake të parapara me normën pozitive në Republikën e Kosovës, me shumicën e votave për, dy abstenime dhe një votë kundër.

3. Dalja në opinion e shifrës prej **4,177,032.00 Euro** si humbje e Ndërrmarjes N.H. "Ibër-Lepenc" në vitin 2017 është e pa qëndrueshme dhe e pa bazuar.  
Me Planin e Biznesit për vitin 2017 Ndërrmarja "Ibër-Lepenc" ka paraparë të hyra në shumë prej **4,266,843.00 Euro**, kurse ka realizuar të hyra në shumë prej **4,204,157.00 Euro**, shpenzimet operative kanë qenë në shumë prej **3,737,323.00 Euro**, dhe fitimi operativ ka qenë në shumë prej **466,834.00 Euro**. Shifra prej **4,177,032.00 Euro** e paraqitur si humbje e N.H. "Ibër-Lepenc" për vitin 2017, është zhvlerësim dhe trajtohet si humbje nominale duke mos pasur efekt monetar (referuar Studimit të Fizibilitetit për Mbrojtjen e Kanalit Ibër Lepenc, Kosovë, Vëllimi 2).
4. Ndërrmarja "Ibër-Lepenc" e ka respektuar vendimin e Ministrit Lluka me nr. 012599 të dt.18.12.2017, të cilin e ka kuptuar ashtu sikurse është përmbajtja e tij – ndalesë e përkohshme e dhënjes së bonuseve përkatësisht paradhënjeve deri në plotësimin e kushteve të parapara me ligj. Pikërisht për këtë arsye, në prag të festave të Vitit të Ri 2018, nuk janë dhënë paradhënje, të cilat do të barazoheshin me rastin e dhënjes së bonuseve, kur të krijohen kushtet ligjore për ndarjen e tij, praktikë kjo e cila kishte qenë në këtë Ndërrmarje edhe në kohën kur bashkë-nënshkruesi i Propozim-Vendimit z. Nazmi Zenelaj, aktualisht Sekretar i Përgjithshëm në MZHE, ka qenë kryesues i Bordit të Drejtorëve në Ndërrmarjen "Ibër-Lepenc".
5. Sa i përket rekomandimit të Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërrmarjeve Publike që të rishqyrtohet Vendimi për ndarjen e bonuseve, Bordi i Drejtorëve, të njejtin do ta ketë në rend dite për shqyrtim në mbledhjen e parë të ardhëshme të rregullt të Bordit pas marrjes së rekomandimit e cila është e ftuar për dt.11.05.2018. Shtrojmë pyetjen z.

1. ST  
2. J. L.  
3. A.M.  
4. S.V.




Ministër dhe z. Sekretar i Përgjithshëm i MZHE-së, përderisa na e dërguat Rekomandimin, përse po ju ngutet kaq shumë, që çështjen ta dërgoni në Qeverinë e Republikës së Kosovës, me Propozim-Vendim për shkarkim të Drejtorëve të Bordit të cilët votuan pro e që ishin shumicë, duke na e mohuar të drejtën e rishqyrtimit të rekomandimit tuaj!

6. Të nderuar, ndëshkimi i drejtorëve të Bordit të Drejtorëve me shkarkim për shkak të votimit sipas bindjeve të tyre të lira, **është shkelje e dispozitave të nenit 7 parag. 7.3 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërrmarjet Publike**, i cili parasheh se shkarkimi mund të meret parasyshë vetëm nëse Ndërrmarja Publike dështon në arritjen e caqeve të saja të performancës për dy vite financiare radhazi nëse aksionari nuk e arsyeton dështimin e asesi, për shkak të votimit të bazuar në dispozita ligjore dhe bindje vetanake, madje edhe duke qenë votim i shumicës.
7. Konsiderojmë se Propozim-Vendimi juaj është i paligjshëm edhe për faktin se përfshinë UD Kryeshefin Ekzekutiv të Ndërrmarjes. Ju rikujtojmë se paragrafi 15.1 i nenit 15 të ligjit LNP nr. 03/L-087 thot që: "...të gjithë drejtorët, përveç njërit, do të zgjidhen nga Qeveria; dhe secili drejtor i zgjedhur në këtë mënyrë shërben me mandat prej tri (3) viteve. Drejtori tjetër do të jetë KE i NP-së dhe zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me nenin 21 të këtij ligji". Prandaj, përfshirja e UD KE në Propozim-Vendimin e juaj është në kundërshtim me dispozitën e lartëshënuar të LNP nr. 03/L-087, pasi që i njëjti (KE) përderisa zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve, i jep llogari Bordit dhe nuk mund të jetë objekt trajtimi, në rastin konkret i shkarkuar nga Qeveria, e cila nuk ka kompetenca në këtë pozitë.
8. Propozuesit gjithashtu me Propozim-Vendim përveqëse kanë bërë shkelje të dispozitave materiale përkatësisht dispozitave të nenit 5 parag. 5.1 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërrmarjet Publike, kanë kryer edhe shkelje procedurale duke ja mohuar Komisionit Ndër-ministror për Ndërrmarje Publike të drejtën dhe detyrimin ligjor që të meret me këtë çështje para se e njëjta të kalojë në Qeveri. Ky Komision nuk është njoftuar fare

1. S. H.  
2. S. H.  
3. A. H.  
4. S. H.

dhe sikur të njoftohej, i njëjti ose do ta tejkalonte problemin ose do të përgatiste debat për mbledhjen e Qeverisë.

9. Në praktikat juridike të deri tanishme, të sistemeve demokratike, nuk kemi hasur të dëgjojmë se dikush ndëshkohet për shprehjen e lirë të mendimit të vet, pa ju dhënë mundësia e mbrojtjes madje edhe në rastet kur deklarimi ka qenë me shumicë votash.
10. Në raportin vjetor të Ndërrmarjes, i cili është aprovuar me vota unanime të të gjithë drejtorëve në Bordin e Drejtorëve, dhe për këtë është njoftuar edhe NJPMNP, ka qenë e paraparë edhe dhënja e bonusit dhe nuk ka pasur asnjë reagim apo mospajtim qoftë nga NJPMNP qoftë nga dy Drejtorët e Bordit të cilët abstenuan apo nga Drejtori që votoi kundër. **Menaxhmenti i Ndërrmarjes në përputhje me planin e biznesit 2017 ka kalkuluar si kosto zërin e pagave bruto 2017, pozicionin që ju e kontestoni, me vota unanime.**
11. Opinioni për performancën e Ndërrmarjes “Ibër-Lepenc” si Ndërrmarje e qëndrueshme financiarisht, e vlerësuar kështu edhe nga ju z. Ministër (e konfirmuar me dt. 22.12.2018 me rastin e vizitës në N.H. “Ibër-Lepenc” dhe e ri-konfirmuar më dt. 06.04.2018 në takimin mes përfaqësuesve të N.H. “Ibër-Lepenc” dhe “KRU Mitrovica”), ndryshon në momentin kur procesi për plotësimin e pozitës së KE-së është i hapur dhe drejt finalizimit. Ky është një veprim tëpër i dukshëm për interesa të ngushta, ju bëjmë me dije se në asnjë rrethanë nuk mund ta fshehni qëllimin final, krijimin e ambientit favorizues për përzgjedhjen e KE-së.
12. Në funksion të ruajtjes së stabilitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të Ndërrmarjes N.H. “Ibër-Lepenc” e cila nuk ka obligime financiare (të gjitha detyrimet i shlyen me kohë), pagat miren me kohë, asetet e Ndërrmarjes i ka funksionale dhe në gjendje operative, nuk ka vërejtje nga asnjë klient i Ndërrmarjes apo pakënaqësi të konsumatorit (shih raportin e kënaqshmërisë të klientëve). Aktualisht në xhirollogari ka para të gatshme prej **666,047.00 Euro**, ka kërkesa të pa arkëtueshme nga klientet e saj si

1.   
2.   
3.   
4. S.V.

nga: Kosova B mospagesa e faturave mujore për muajt janar, shkurt, mars,dhe prill në vlerë prej **282,174.83 Euro**, nga Feronikeli mospagesa e faturave mujore në shumë prej **165,877.02 Euro**, si dhe nga KRU Mitrovica mospagesa e faturave mujore në shumë prej **914,741.49 Euro**, duke anashkaluar kërkesat e vogla nga bujqit, **i nderuari z. Ministër ju ftojme që ta respektoni ligjin dhe mos ndërhyni përkatësisht mos intereferoni në pavarësinë e Bordit të Drejtorëve, të garantuar me nenin 7 parag. 7.6 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërrmarjet Publike, për të manipuluar opinionin publik për të arritur qëllime të dukshme për Ndërrmarjen "Ibër-Lepenc", me të vetmin qëllim që të arrini ndikimin në pozitën e KE-së. Përndryshe veprimet eventuale të paligjshme, përveqëse do ti kontestojmë, do të kërkojmë edhe lëshimin e Masave të Përkohshme për shtyrjen e ekzekutimit të tyre, si dhe do ta njoftojmë opinionin në Kosovë, duke ju ftuar për ballafaqim edhe në debate televizive.**

Me respekt,

Anëtarët e Bordit të NH "Ibër-Lepenc" SH.A

Fatos Sahiti- Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Imer Hamiti- Kryesues i Komisionit të Auditimit

Albiona Maloku- Anëtare

Sami Veliu- U.D Kryeshef Ekzekutiv